



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, më 2 gusht 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar (në mungesë)
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë "Radio Lushnja" sh.p.k., e licencuar për subjektin audio privat vendor "Radio Lushnja" për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare, për qytetin "Lushnjë" (**Vendimi nr. 62, datë 02.08.2023**).
2. Pranimin e kërkesës për kalimin e të drejtave të licencës të shoqërisë "RTV Adria – Med" sh.p.k., licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv "Premium Channel", me zonë ofrimi të shërbimit "Qarqet Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë", te shoqëria "Premium Media" sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat "Radio Travel" dhe autorizuar për ofrimin e shërbimit audioviziv online "Premium Travel" (**Vendimi nr. 63, datë 02.08.2023**).
3. Miratimin e kërkesës për konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit për personin fizik Guri Meko, i autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "TV Kabllor Aral" (**Vendimi nr. 64, datë 02.08.2023**).
4. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "Radio One Albania" sh.p.k, e licencuar për subjektin audio privat vendor "Radio One", për ndryshimin e emrit të subjektit tregtar nga "Dynamicsound" sh.p.k. në "Radio One Albania" sh.p.k. (**Vendimi nr. 65, datë 02.08.2023**).
5. Vendosjen e sanksionit me gjobë ndaj kanalit 'RTSH FILM', të transmetuesit publik "Radio Televizioni Shqiptar", për transmetimin e përmbajtjes të papërshtatshme në mesditën e datës

19.07.2023, në shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (**Vendimi nr. 66, datë 02.08.2023**).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 2 gusht 2023